



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 18.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 04.04.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik 17.04.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Truly Nolen SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-2180- 2-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-030-221, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik “Truly Nolen” sh.p.k., e dt.17.04.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-2180- 2-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-030-221, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 21.03.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të publikuar me datë: 21.03.2025;**
- 3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .**

Arsyetim

Operatori ekonomik "Truly Nolen" sh.p.k. me dt.17.04.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-2180- 2-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-030-221.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 18.04.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Sipas kërkesa ligjore nga Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë (i përditësuar me ligjet përkatëse), Autoritetet Kontraktuese kanë të drejtë të vendosin kushte kualifikuese teknike dhe profesionale për të garantuar:

- Përmbushjen me sukses të kontratës.
- Pjesëmarrjen vetëm të kompanive me kapacitet të vërtetuar teknik dhe profesional.

Kërkesa a) dhe b) janë kërkesa teknike minimale që sigurojnë autoritetin kontraktues se OE kanë aftësi teknike për të përfunduar një shërbim të fushës të cilën ne e kërkojmë dhe është objekt e kontratës në fjalë. Këto kërkesa nuk përmbajnë ndonjë kërkesë apo certifikatë specifike, të tepruara apo penguese, por paraqesin standarde të zakonshme në fushën e këtyre shërbimeve në përputhje me natyrën e shërbimit dhe rrezikshmërinë e materialeve të përdorura.

SQARIM : Kërkesa për së paku 30 punëtorë lidhet me:

- Kapacitetin për të përmbushur kontratën në kohë dhe cilësi, sidomos nëse zona e ndërhyrjes është e madhe ose në më shumë lokacione njëkohësisht.
- Minimizimin e vonesave për shkak të mungesës së fuqisë punëtore.
- Zbatimin e standardeve operative, që kërkojnë ekipe të specializuara dhe të ndara për dezinfektim, deratizim, etj.

SQARIM : Kërkesa për Bachelor në Kimi Inxhinierike lidhet me:

Shërbimet e DDD janë të ndjeshme sepse përfshijnë përdorimin e kimikateve dhe mjeteve që ndikojnë drejtpërdrejt në mjedisin dhe shëndetin e njerëzve. Prandaj, AK kërkon:

- Bachelor në Kimi Inxhinierike: për të garantuar që ekziston ekspertizë profesionale që kontrollon përbërësit kimikë, dozimin dhe mënyrën e aplikimit në përputhje me standardet e sigurisë.

Neni 25

Kriteret e përzgjedhjes (Sa i përket pikës, c),d) dhe pikës 3,2, OE nuk mund të tregoi AK se çfarë kërkesa minimale duhet të kërkoj, që ti plotësohen vetëm OE Truly Nolen SHPK dhe të mos ketë mundësi asnjë OE tjetër të aplikoj.

25.3 Kërkesat minimale të kualifikimit, mund të përcaktohen nga AK, kur AK konstaton se është e nevojshme për të siguruar që vetëm OE që posedojnë aftësi të caktuara profesionale, financiare ose teknike do të marrin pjesë në konkurrencë për kontratë.

25.6 Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.

Pra, AK konsideron që pretendimet e juaja janë të pabazuara dhe që kërkesat e parashtruara në FDT janë minimalisht të mjaftueshme dhe si të tilla mbesin të pa ndryshuara.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

